

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

RAPORT MBI VLERËSIMIN E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI

VITI AKADEMIK 2025–2026

Institucioni	: Universiteti Metropolitan Tirana
Njësia përgjegjëse	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha kohore	: 25 maj – 05 qershor 2026
Metoda e plotësimit	: Online – Edu4School
Numri i pjesëmarrësve	: 446 studentë
Përgatiti	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Data e publikimit	: 22 qershor, 2026

Përmbajtja

HYRJE.....	4
METODOLOGJIA.....	4
PËRBËRJA E NJSBC PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026.....	5
KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË TË ANKETUARVE.....	6
SHPËRNDARJA E STUDENTËVE TË ANKETUAR SIPAS PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	7
VLERËSIMI INSTITUCIONAL I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI.....	10
Vlerësimi institucional i programeve të studimit Bachelor.....	10
Vlerësimi institucional i programeve të studimit Master.....	13
I. FAKULTETI I EKONOMISË.....	16
1.1. DEPARTAMENTI INFORMATIKË EKONOMIKE.....	16
1.1.1. BA në "Informatikë Ekonomike" (anglisht).....	16
1.1.2. BA në "Informatikë Ekonomike" (shqip).....	19
1.1.3. MSc në "Menaxhim në Inxhinieri".....	22
1.1.4. MSc në "Business Analytics & Artificial Intelligence".....	25
1.2. DEPARTAMENTI I SHKENCAVE ADMINISTRATIVE.....	28
1.2.1. BA në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion"	28
1.2.2. MSc në "Ekonomik - MBA".....	31
1.2.3. Master Profesional në "Marketing Dixhital".....	34
1.2.4. Program profesional në "Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente" 37	
1.3. DEPARTAMENTI FINANCË- BANKË.....	40
1.3.1. BA në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech".....	40
1.3.2. MSc në "Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku".....	43
II. FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE DHE IT.....	46
2.1. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË KOMPJUTERIKE.....	46
2.1.1. BA në "Inxhinieri Kompjuterike".....	46
2.1.2. BA në "Inxhinieri Software" (anglisht).....	49
2.1.3. BA në "Inteligjencë Artificiale".....	52
2.1.4. MSc në "Inxhinieri Informatike".....	55
2.1.5. MSc në "Inteligjencë Artificiale" me profile "Cyber Security" dhe "Data Science"	58
2.1.6. Program Profesional në "Dizajn dhe Zhvillim Software".....	61
2.2. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE.....	64
2.2.1. BA në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime dixhitale"	64
2.2.2. MSc në Inxhinieri Elektrike me dy profile: "Energjetikë", "Automatizim Industrie"	67
III. FAKULTETI I INXHINIERISË DHE ARKITEKTURËS.....	70

3.1. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT.....	70
3.1.1. BA në "Inxhinieri Ndërtimi".....	70
3.1.2. MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri Strukturash", "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti	73
3.2. DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS.....	76
3.2.1. Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë.....	76
3.2.2. Program Profesional në "Grafik Dizajn".....	79
Aneks - FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI.....	82

HYRJE

Vlerësimi i programeve të studimit nga studentët në prag diplomimi përbën një nga instrumentet e rëndësishme të sigurimit të brendshëm të cilësisë në arsimin e lartë. Duke qenë se realizohet në përfundim të ciklit të studimeve, ai ofron mundësinë për të mbledhur perceptimet e studentëve pasi kanë përjetuar të gjithë procesin akademik, administrativ dhe profesional të programit.

Ky raport mbështetet në të dhënat e mbledhura përmes formularit standard të vlerësimit të programeve të studimit nga studentët në prag diplomimi, pjesë e paketës së instrumenteve të cilësisë të zhvilluara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Analiza e rezultateve synon të identifikojë pikat e forta të programeve, aspektet që kërkojnë vëmendje të mëtejshme dhe mundësitë për përmirësim të vazhdueshëm, duke kontribuar në vendimmarrjen e bazuar në evidencë dhe në zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë akademike dhe institucionale.

METODOLOGJIA

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit të vlerësimit të programeve të studimit nga studentët në prag diplomimi. Pyetësi u administrua në mënyrë elektronike përmes platformës Edu4School gjatë periudhës 25 maj – 5 qershor 2026. Plotësimi i tij ishte anonim dhe vullnetar, duke synuar të krijojë kushtet për shprehjen e lirë të perceptimeve dhe përvojave të studentëve lidhur me programet e tyre të studimit.

Në studim morën pjesë gjithsej 446 studentë, prej të cilëve 319 studentë të programeve Bachelor dhe 127 studentë të programeve Master. Të gjithë të anketuarit ishin studentë të viteve përfundimtare të studimeve, çka u mundësonte atyre të vlerësonin programin mbi bazën e një eksperience të plotë akademike dhe institucionale.

Pyetësi ishte i strukturuar në katër dimensionet kryesore të cilësisë së programit të studimit:

- Përmbajtja dhe organizimi i programit;
- Mësimdhënia dhe stafi akademik;
- Infrastruktura dhe mbështetja institucionale;
- Përvoja personale dhe zhvillimi profesional.

Vlerësimi i secilit pohim u realizua përmes një shkalle Likert me pesë nivele, ku vlera 1 përfaqësonte nivelin më të ulët të vlerësimit dhe vlera 5 nivelin më të lartë.

Përpunimi statistikor i të dhënave u realizua me programin SPSS. Në fazën e parë u krye analiza deskriptive në nivel institucional, duke përfshirë të gjithë studentët e programeve Bachelor dhe, veçmas, të programeve Master. Për secilin pohim u llogaritën numri i përgjigjeve (N), vlera minimale dhe maksimale, mesatarja aritmetike (Mean) dhe devijimi standard (Standard Deviation), me qëllim identifikimin e tendencave kryesore të vlerësimit dhe shkallës së variacionit të përgjigjeve.

Në fazën e dytë, analiza u zhvillua në nivel programi studimi, duke mundësuar evidentimin e veçorive dhe perceptimeve specifike të studentëve për secilin program Bachelor dhe Master. Kjo qasje lejoi jo vetëm krijimin e një panorame të përgjithshme institucionale, por edhe identifikimin e pikave të forta dhe aspekteve që mund të përfitojnë nga përmirësime në nivel programi.

Interpretimi i rezultateve është organizuar sipas katër dimensioneve të pyetësorit, duke kombinuar analizën statistikore të treguesve me interpretimin cilësor të perceptimeve të studentëve. Në këtë mënyrë, raporti synon të ofrojë një pasqyrë të argumentuar mbi cilësinë e programeve të studimit dhe të kontribuojë në proceset e monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.

Shënim metodologjik: Programi *MSc në “Inxhinieri Software”* nuk është përfshirë në analizën interpretuese në nivel programi, pasi në anketim morën pjesë vetëm **3 studentë**. Duke qenë se ky numër nuk ofron një bazë të mjaftueshme për interpretim të besueshëm të rezultateve, të dhënat e këtij programi nuk janë analizuar veçmas, megjithëse janë përfshirë në analizën institucionale të programeve Master.

PËRBËRJA E NJSBC PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues nga administrata, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Kryetari dhe anëtarët e njësisë janë miratuar nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.

N ^o	Emri Mbiemri	Funksioni	Përfaqësimi
1	Dr.Marsida Gorea	Kryetare	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
2	Dr.Almarin Frakulli	Anëtar	Fakulteti i Ekonomisë
3	MSc. Virtyt Lesha	Anëtar	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
4	MSc Albina Joga	Anëtare	Adiministrata
5	Prof.Asoc.Dr. Ramadan Çipuri	Anëtar	Ekspert i jashtëm
6	Anja Balliu	Anëtare	Përfaqësuese e studentëve

KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE TË TË ANKETUARVE

Në vlerësimin e programeve të studimit morën pjesë studentë të viteve të fundit të ciklit Bachelor dhe Master, të cilët ndodheshin në prag diplomimi.

Tabela 1 Shpërndarja e studentëve të anketuar sipas gjinisë në programet Bachelor

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	111	34.8	34.8	34.8
	Mashkull	208	65.2	65.2	100.0
	Total	319	100.0	100.0	

Në ciklin **Bachelor**, në anketim morën pjesë gjithsej 319 studentë, nga të cilët 208 (65.2%) ishin meshkuj dhe 111 (34.8%) femra. Të dhënat tregojnë një përfaqësim dukshëm më të lartë të studentëve meshkuj në programet Bachelor të përfshira në studim.

Në ciklin **Master**, numri i përgjithshëm i të anketuarve ishte 127 studentë, ku 72 (56.7%) ishin meshkuj dhe 55 (43.3%) femra. Krahësuar me ciklin Bachelor, vihet re një shpërndarje më e balancuar gjinore, megjithëse studentët meshkuj mbeten grupi më i përfaqësuar.

Tabela 2 Shpërndarja e studentëve të anketuar sipas gjinisë në programet Master

Gjinia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	55	43.3	43.3	43.3
	Mashkull	72	56.7	56.7	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Në total, studimi përfshin 446 studentë nga programet Bachelor dhe Master, duke ofruar një bazë të gjerë dhe të besueshme për vlerësimin e përvojës studentore dhe perceptimeve mbi cilësinë e programeve të studimit në prag të përfundimit të tyre akademik.

SHPËRNDARJA E STUDENTËVE TË ANKETUAR SIPAS PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Për shkak të natyrës së anketimit, shpërndarja e studentëve sipas programeve të studimit pasqyron në masë të madhe madhësinë e secilit program dhe numrin e studentëve që ndodheshin në prag diplomimi gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave. Në total, në anketim morën pjesë 319 studentë nga 13 programe studimi të ciklit Bachelor dhe programeve profesionale.

Pjesëmarrjen më të lartë e kanë regjistruar programet BA në Inxhinieri Software (14.7%), BA në Inxhinieri Ndërtimi (13.2%) dhe BA në Inxhinieri Kompjuterike (12.5%), të ndjekura nga BA në Informatikë Ekonomike (shqip) (10.7%). Nga ana tjetër, pjesëmarrje më të ulët kanë pasur programet me numër më të vogël studentësh, si BA në Financë (2.2%), BA në Inteligjencë Artificiale (3.1%) dhe Programi Profesional në Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente (4.1%).

Tabela 3 Shpërndarja e studentëve të anketuar sipas programeve të studimit në ciklin Bachelor

Programi i studimit:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	BA në "Informatike Ekonomike" (anglisht)	25	7.8	7.8	7.8
	BA në "Informatikë Ekonomike" (shqip)	34	10.7	10.7	18.5
	BA në "Inteligjencë Artificiale"	10	3.1	3.1	21.6
	BA në "Inxhinieri Kompjuterike"	40	12.5	12.5	34.2
	BA në "Inxhinieri Ndërtimi"	42	13.2	13.2	47.3
	BA në "Inxhinieri Software" (anglisht)	47	14.7	14.7	62.1
	BA në Administrim Biznesi me profile: "Menaxhim", "Marketing", "Sipërmarrje dhe Inovacion"	17	5.3	5.3	67.4
	BA në Financë me dy profile: "Kontabilitet", "FinTech"	7	2.2	2.2	69.6
	BA në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë",	22	6.9	6.9	76.5

	“Elektronikë”, “Komunikime dixhitale”, “Kontroll inxhinierik”, “Makinieri elektrike”				
	Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë	19	6.0	6.0	82.4
	Program Profesional në “Dizajn dhe Zhvillim Software”	25	7.8	7.8	90.3
	PP në “Grafik Dizajn”	18	5.6	5.6	95.9
	PP në “Menaxhim në Turizëm, Hoteleri dhe Evente”	13	4.1	4.1	100.0
	Total	319	100.0	100.0	

Kjo shpërndarje nuk përbën një tregues vlerësimi të programeve, por reflekton përbërjen e grupit të studentëve të përfshirë në studim dhe siguron përfaqësimin e programeve të ndryshme në analizën e mëtejshme të rezultateve.

Për ciklin Master, në anketim morën pjesë 127 studentë nga 10 programe studimi. Shpërndarja e të anketuarve sipas programeve pasqyron kryesisht numrin e studentëve të regjistruar dhe atyre që ndodheshin në prag diplomimi në secilin program gjatë periudhës së realizimit të anketimit.

Pjesëmarrjen më të lartë e ka regjistruar programi MSc në Inxhinieri Ndërtimi, me 56 studentë (44.1%), duke përbërë pothuajse gjysmën e të gjithë të anketuarve në ciklin Master. Më pas renditen Master në Inxhinieri Elektrike, me 14 studentë (11.0%), MSc në Artificial Intelligence, me 12 studentë (9.4%) dhe MSc në Business Analytics & Artificial Intelligence me 10 studentë (7.9%). Programet e tjera përfaqësohen me numra më të vegjël studentësh, në përputhje me madhësinë e tyre.

Tabela 4 Shpërndarja e studentëve të anketuar sipas programeve të studimit në ciklin Master

Programi i studimit:					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	MSc në Inxhinieri Elektrike me dy profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrie”	14	11.0	11.0	11.0
	Master Profesional në “Marketing Dixhital”	3	2.4	2.4	13.4
	MSc në “ Inteligjencë Artificiale” me profile “Cyber Security” dhe “Data Science”	12	9.4	9.4	22.8
	MSc në “Business Analytics & Artificial Intelligence”	10	7.9	7.9	30.7
	MSc në “Ekonomik – MBA”;	3	2.4	2.4	33.1
	MSc në “Inxhinieri Financiare dhe Menaxhim Risku”	9	7.1	7.1	40.2
	MSc në “Inxhinieri Informatike”	9	7.1	7.1	47.2
	MSc në “Inxhinieri Software”	3	2.4	2.4	49.6

	MSc në "Menaxhim në Inxhinieri"	8	6.3	6.3	55.9
	MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri Strukturash", "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti"	56	44.1	44.1	100.0
	Total	127	100.0	100.0	

Ashtu si në ciklin Bachelor, kjo shpërndarje shërben për të paraqitur përbërjen e grupit të studentëve të përfshirë në studim dhe nuk përbën në vetvete një tregues të cilësisë apo vlerësimit të programeve të studimit.

VLERËSIMI INSTITUCIONAL I PROGRAMEVE TË STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI

Vlerësimi institucional i programeve të studimit Bachelor

Përmbajtja dhe organizimi i programeve

Vlerësimet e studentëve për përmbajtjen dhe organizimin e programeve Bachelor janë përgjithësisht të larta, me mesatare që variojnë nga 3.82 deri në 4.27. Vlerësimin më të lartë e merr relevanca e përmbajtjes së programit për profesionin e zgjedhur ($M = 4.27$), e ndjekur nga organizimi i qartë dhe logjik i programit ($M = 4.25$) dhe përballueshmëria e ngarkesës mësimore ($M = 4.26$). Vlerësimi relativisht më i ulët i këtij grupi lidhet me aftësinë e metodave të mësimdhënies për të nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve ($M = 3.82$), *duke sugjeruar një hapësirë të moderuar për përmirësim në aspektin e angazhimit aktiv të studentëve në procesin mësimor*. Në tërësi, rezultatet tregojnë se studentët e vlerësojnë pozitivisht strukturën dhe përmbajtjen akademike të programeve Bachelor.

Mësimdhënia dhe stafi akademik

Ky dimension paraqet disa nga vlerësimet më të larta të të gjithë pyetësorit. Studentët vlerësojnë veçanërisht angazhimin e pedagogëve për të ndihmuar dhe adresuar shqetësimet e tyre ($M = 4.31$), si dhe nxitjen e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive ($M = 4.30$). Edhe kompetenca profesionale e stafit akademik ($M = 4.28$) dhe drejtësia e procesit të vlerësimit ($M = 4.25$) marrin vlerësime të larta. Këto rezultate tregojnë një perceptim shumë pozitiv të studentëve ndaj cilësisë së mësimdhënies dhe rolit të stafit akademik në mbështetjen e procesit të të nxënies.

Infrastruktura dhe mbështetja institucionale

Vlerësimet për infrastrukturën dhe mbështetjen institucionale janë gjithashtu pozitive, me mesatare mbi vlerën 4.00 për të gjithë indikatorët. Mundësitë për mobilitet ndërkombëtar dhe përfshirje në projekte ndërkombëtare marrin vlerësimin më të lartë në këtë kategori ($M = 4.25$), të ndjekura nga shërbimet administrative ($M = 4.21$). Vlerësimet më të ulëta lidhen me kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.06$) dhe me auditorët e laboratorët ($M = 4.14$), megjithëse edhe këto mbeten në një nivel pozitiv. Në përgjithësi, studentët shprehen të kënaqur me kushtet

infrastrukturore dhe shërbimet mbështetëse të ofruara nga universiteti.

Përvoja personale dhe zhvillimi profesional

Studentët vlerësojnë pozitivisht ndikimin e programeve Bachelor në zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Vlerësimet më të larta lidhen me zhvillimin e etikës dhe disiplinës në marrëdhëniet profesionale ($M = 4.25$) dhe ndikimin e përgjithshëm pozitiv të programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.24$). Gjithashtu, studentët raportojnë se ndihen të përgatitur për tregun e punës dhe për fillimin e karrierës profesionale, me vlerësime që variojnë nga 4.15 në 4.18. Rezultatet sugjerojnë se programet Bachelor perceptohen si kontribuuese në formimin profesional dhe personal të studentëve, si dhe në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për jetën profesionale.

Tabela 5 Perceptimet e studentëve mbi cilësinë e programeve të studimit Bachelor në nivel institucional

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	319	1	5	4.25	1.039
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	319	1	5	4.27	1.002
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	319	1	5	4.16	1.095
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	319	1	5	4.26	1.008
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	319	1	5	4.23	1.021
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	319	1	5	4.17	1.128
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	319	1	5	3.82	1.127
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	319	1	5	4.23	1.072
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	319	1	5	4.19	1.075
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	319	1	5	4.28	1.017

Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	319	1	5	4.31	1.015
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	319	1	5	4.25	1.019
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	319	1	5	4.30	.999
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimi	319	1	5	4.14	1.099
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	319	1	5	4.17	1.081
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	319	1	5	4.16	1.116
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	319	1	5	4.21	1.038
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	319	1	5	4.06	1.198
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	319	1	5	4.25	1.056
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	319	1	5	4.24	1.058
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përbushur kërkesat e tregut të punës	319	1	5	4.15	1.116
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	319	1	5	4.18	1.080
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	319	1	5	4.18	1.072
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	319	1	5	4.15	1.124
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	319	1	5	4.25	1.036
Valid N (listwise)	319				

Vlerësimi institucional i programeve të studimit Master

Përmbajtja dhe organizimi i programit

Studentët e programeve Master shprehin vlerësime shumë pozitive për përmbajtjen dhe organizimin e programeve të studimit. Vlerësimet mesatare për të gjithë indikatorët e këtij dimensionit janë mbi 4.25, ndërsa organizimi i qartë dhe logjik i programit ($M = 4.44$) dhe përballueshmëria e ngarkesës mësimore ($M = 4.42$) rezultojnë aspektet më të vlerësuara. Po ashtu, studentët vlerësojnë lart relevancën e përmbajtjes së programit për profesionin e zgjedhur dhe kontributin e tij në zhvillimin e aftësive analitike. Në tërësi, rezultatet tregojnë se programet Master perceptohen si të strukturuar mirë dhe të orientuara drejt nevojave akademike e profesionale të studentëve.

Mësimdhënia dhe stafi akademik

Ky dimension paraqet vlerësimet më të larta të gjithë pyetësorit. Studentët vlerësojnë veçanërisht kompetencën profesionale të pedagogëve ($M = 4.52$), drejtësinë dhe transparencën e vlerësimit ($M = 4.49$), si dhe gatishmërinë e stafit akademik për të mbështetur studentët ($M = 4.47$). Edhe nxitja e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive vlerësohet pozitivisht ($M = 4.43$). Këto rezultate dëshmojnë një nivel të lartë besimi të studentëve ndaj cilësisë së mësimdhënies dhe rolit të pedagogëve në procesin akademik.

Infrastruktura dhe mbështetja institucionale

Vlerësimet për infrastrukturën dhe mbështetjen institucionale janë përgjithësisht pozitive, me mesatare që variojnë nga 4.23 deri në 4.37. Mundësitë për mobilitet ndërkombëtar dhe përfshirje në projekte ndërkombëtare vlerësohen më lart ($M = 4.37$), ndërsa auditorët, laboratorët dhe pajisjet teknologjike marrin gjithashtu vlerësime të mira. Vlerësimet relativisht më të ulëta brenda këtij dimensionit lidhen me kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.23$), megjithëse edhe ky tregues mbetet në një nivel pozitiv. Në përgjithësi, studentët shprehen të kënaqur me mbështetjen institucionale të ofruar gjatë studimeve të tyre.

Përvoja personale dhe zhvillimi profesional

Rezultatet tregojnë se programet Master perceptohen se kontribuojnë ndjeshëm në zhvillimin personal dhe profesional të studentëve. Vlerësimet më të larta lidhen me përgatitjen për fillimin e karrierës profesionale dhe zhvillimin e aftësive për planifikim e menaxhim ($M = 4.38$), si dhe me ndikimin e përgjithshëm pozitiv të programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.34$). Studentët raportojnë gjithashtu se kanë fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës ($M = 4.33$). Edhe pse praktikat profesionale paraqesin vlerësimin më të ulët të këtij dimensionit ($M = 4.28$), ato mbeten të vlerësuara pozitivisht. Në tërësi, programet Master perceptohen se ofrojnë një kontribut të rëndësishëm në formimin profesional dhe përgatitjen për tregun e punës.

Tabela 6 Perceptimet e studentëve mbi cilësinë e programeve të studimit Master në nivel institucional

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	127	1	5	4.44	.823
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	127	1	5	4.37	.958
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	127	1	5	4.29	1.085
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	127	1	5	4.42	.912
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	127	1	5	4.37	.974
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	127	1	5	4.38	.991
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	127	1	5	4.37	.982
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	127	1	5	4.29	1.062
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	127	1	5	4.30	.995
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	127	1	5	4.52	.881
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar	127	1	5	4.47	.880

shqetësimet e tyre					
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	127	1	5	4.49	.907
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	127	1	5	4.43	.973
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimi	127	1	5	4.35	1.072
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	127	1	5	4.34	1.033
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	127	1	5	4.30	1.056
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	127	1	5	4.28	1.132
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	127	1	5	4.23	1.149
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	127	1	5	4.37	.974
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	127	1	5	4.34	1.033
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	127	1	5	4.33	1.062
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	127	1	5	4.38	.999
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	127	1	5	4.38	1.015
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	127	1	5	4.28	1.152
Valid N (listwise)	127				

I. FAKULTETI I EKONOMISË

1.1. DEPARTAMENTI INFORMATIKË EKONOMIKE

1.1.1. BA në “Informatikë Ekonomike” (anglisht)

Vlerësimet e studentëve të programit **BA në Informatikë Ekonomike (anglisht)** janë përgjithësisht pozitive në të gjitha dimensionet e pyetësorit. Në aspektin e përmbajtjes dhe organizimit, studentët vlerësojnë veçanërisht relevancën e programit për profesionin e zgjedhur ($M = 4.36$), si dhe përballueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.40$). Njëkohësisht, rezulton se metodat e mësimdhënies që synojnë nxitjen e pjesëmarrjes aktive të studentëve marrin një vlerësim disi më të moderuar ($M = 3.88$), çka sugjeron se *ka ende hapësirë për rritjen e angazhimit interaktiv në procesin mësimor*.

Një nga pikat më të forta të programit lidhet me stafin akademik. Studentët vlerësojnë lart përgatitjen dhe kompetencën e pedagogëve ($M = 4.44$), si edhe drejtësinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit ($M = 4.40$). Po ashtu, mbështetja e ofruar nga pedagogët dhe nxitja e mendimit kritik perceptohen pozitivisht, duke reflektuar një marrëdhënie të mirë akademike ndërmjet studentëve dhe stafit mësimdhënës.

Në dimensionin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, vlerësimet mbeten pozitive, por paraqesin një variacion më të madh. Shërbimet administrative ($M = 4.28$) dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.32$) vlerësohen mirë, ndërsa auditorët, laboratorët dhe pajisjet teknologjike marrin vlerësime disi më të ulëta, por ende të kënaqshme. Treguesi me rezultatin më të ulët në këtë grup lidhet me kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 3.84$), duke sugjeruar se *studentët do të dëshironin një lidhje më të fortë ndërmjet programit dhe përvojave praktike në mjedise reale pune*.

Për sa i përket ndikimit të programit në zhvillimin personal dhe profesional, studentët shprehen pozitivisht për aftësitë dhe njohuritë e fituara. Ata vlerësojnë se programi ka kontribuar në zhvillimin e etikës profesionale ($M = 4.36$) dhe se i ka ndihmuar të përgatiten për tregun e punës dhe karrierën e ardhshme. Megjithatë praktikatat profesionale marrin një vlerësim më të moderuar ($M = 4.00$), perceptimi i përgjithshëm është se programi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin e tyre akademik dhe profesional.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	25	2	5	4.24	1.012
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	25	2	5	4.36	.952
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	25	2	5	4.28	1.061
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	25	1	5	4.40	1.041
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	25	1	5	4.16	1.028
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	25	2	5	4.24	.926
Metodat e të mësuarit dhe të mësimdhënies kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	25	2	5	3.88	1.013
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	25	2	5	4.20	.913
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	25	2	5	4.16	.943
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	25	3	5	4.44	.768
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	25	2	5	4.36	.907
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	25	3	5	4.40	.816
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	25	3	5	4.36	.810
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimi	25	1	5	3.96	1.136
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	25	1	5	3.92	1.187
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	25	1	5	4.00	1.225
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse	25	3	5	4.28	.792

ndaj studentëve					
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	25	1	5	3.84	1.214
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	25	2	5	4.32	.900
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	25	2	5	4.16	.898
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	25	2	5	4.16	.850
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	25	2	5	4.20	.866
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	25	2	5	4.16	.898
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	25	1	5	4.00	1.155
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	25	2	5	4.36	.860
Valid N (listwise)	25				

a. Programi i studimit: BA në "Informatikë Ekonomike" (anglisht)

1.1.2. BA në “Informatikë Ekonomike” (shqip)

Studentët e programit **BA në Informatikë Ekonomike (shqip)** shprehin një vlerësim pozitiv për përmbajtjen dhe organizimin e programit të studimit. Organizimi i qartë dhe logjik i programit ($M = 4.26$) dhe kontributi i lëndëve në zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve ($M = 4.21$) renditen ndër aspektet më të vlerësuara. Po ashtu, studentët e konsiderojnë programin relevant për profesionin e zgjedhur ($M = 4.18$) dhe vlerësojnë pozitivisht përmbushjen e objektivave akademike dhe profesionale ($M = 4.18$). Ndërkohë, balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës ($M = 4.03$) dhe nxitja e pjesëmarrjes aktive në procesin e të nxënës ($M = 4.00$) marrin vlerësime disi më të moderuara, duke sugjeruar se *studentët do të mirëprisnin forma edhe më të theksuara të angazhimit praktik dhe ndërveprimit gjatë procesit mësimor.*

Dimensioni i mësimdhënies dhe stafit akademik rezulton ndër më të vlerësuarit. Studentët vlerësojnë veçanërisht gatishmërinë e pedagogëve për të ofruar mbështetje dhe për të adresuar shqetësimet e tyre ($M = 4.44$), si dhe kompetencën profesionale dhe aftësinë për të nxitur mendimin kritik ($M = 4.35$). Edhe drejtësia dhe transparenca e procesit të vlerësimit ($M = 4.21$) perceptohen pozitivisht. Në tërësi, rezultatet tregojnë se marrëdhënia ndërmjet studentëve dhe stafit akademik përbën një nga pikat më të forta të programit.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët shprehen më të kënaqur me pajisjet teknologjike të përdorura në procesin mësimor ($M = 4.38$), mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.32$) dhe shërbimet administrative ($M = 4.29$). Auditorët dhe laboratorët ($M = 4.18$), si edhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.09$), vlerësohen gjithashtu pozitivisht. Biblioteka dhe burimet akademike marrin vlerësimin më të ulët në këtë kategori ($M = 3.97$), çka mund të tregojë se *studentët do të dëshironin një përdorim më të gjerë ose një pasurim të mëtejshëm të burimeve akademike në mbështetje të procesit të studimit.*

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë se programi ka kontribuar në formimin e tyre akademik dhe profesional. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.15$), përgatitja për fillimin e karrierës pas diplomimit ($M = 4.18$) dhe zhvillimi i etikës profesionale ($M = 4.21$) marrin vlerësime të mira. Gjithashtu, praktikat profesionale perceptohen si të dobishme për lidhjen e njohurive teorike me mjediset reale të punës ($M = 4.21$). Në përgjithësi, studentët e konsiderojnë programin si një përvojë studimi që u ka ofruar

njohuri, aftësi dhe kompetenca të vlefshme për vazhdimin e karrierës profesionale.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	34	2	5	4.26	.898
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	34	1	5	4.18	.999
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	34	1	5	4.03	1.058
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	34	2	5	4.12	.913
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	34	1	5	4.21	.978
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	34	1	5	4.09	1.190
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	34	1	5	4.00	1.155
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	34	1	5	4.06	1.099
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	34	1	5	4.18	1.086
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	34	1	5	4.35	.950
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	34	2	5	4.44	.746
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	34	2	5	4.21	1.008
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	34	2	5	4.35	.884
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	34	2	5	4.18	.968
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	34	2	5	4.38	.922
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	34	1	5	3.97	1.337
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	34	2	5	4.29	.970

Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	34	1	5	4.09	1.190
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	34	2	5	4.32	.878
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	34	1	5	4.15	1.105
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	34	1	5	4.00	1.206
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	34	1	5	4.18	1.086
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	34	1	5	4.12	1.122
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	34	1	5	4.21	1.067
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	34	1	5	4.21	1.095
Programi i studimit:	34	2	2	2.00	.000
Valid N (listwise)	34				

a. Programi i studimit: BA në "Informatikë Ekonomike" (shqip)

1.1.3. MSc në “Menaxhim në Inxhinieri”

Rezultatet e anketimit tregojnë një nivel jashtëzakonisht të lartë kënaqësie nga studentët e programit **MSc në Menaxhim në Inxhinieri**. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, pothuajse të gjithë treguesit marrin vlerësime shumë të larta, duke reflektuar një perceptim pozitiv për strukturën akademike dhe relevancën e studimeve. Organizimi i programit ($M = 4.88$), relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.75$) dhe zhvillimi i aftësive analitike ($M = 4.75$) vlerësohen në nivele shumë të larta. Veçanërisht domethënës është fakti që ngarkesa mësimore dhe metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve marrin vlerësimin maksimal ($M = 5.00$), duke treguar një përputhje të lartë ndërmjet pritshmërive të studentëve dhe mënyrës së organizimit të programit.

Vlerësimet për mësimdhënien dhe stafin akademik janë ndër më të lartat e regjistruara në të gjithë pyetësin. Të gjithë studentët e anketuar kanë vlerësuar me notën maksimale kompetencën e pedagogëve, angazhimin e tyre ndaj studentëve, drejtësinë e procesit të vlerësimit dhe nxitjen e mendimit kritik ($M = 5.00$ për secilin tregues). Këto rezultate sugjerojnë jo vetëm kënaqësi të lartë me procesin mësimor, por edhe një nivel të konsiderueshëm besimi ndaj stafit akademik që realizon programin.

Edhe infrastruktura dhe mbështetja institucionale vlerësohen shumë pozitivisht. Auditorët dhe laboratorët marrin vlerësimin maksimal ($M = 5.00$), ndërsa biblioteka, kushtet për praktikant profesional dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar vlerësohen me mesatare prej 4.88. Pajisjet teknologjike ($M = 4.75$) dhe shërbimet administrative ($M = 4.75$) perceptohen gjithashtu si mbështetëse të procesit akademik. Në përgjithësi, studentët shprehin se universiteti ka krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e studimeve dhe aktiviteteve të lidhura me programin.

Dimensioni i përvojës personale dhe zhvillimit profesional konfirmon të njëjtën prirje pozitive. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional të studentëve vlerësohet maksimalisht ($M = 5.00$), ndërsa përgatitja për tregun e punës, zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim, si dhe kontributi i praktikave profesionale marrin vlerësime që variojnë nga 4.75 në 4.88. Këto rezultate tregojnë se studentët e konsiderojnë programin jo vetëm si një përvojë akademike të suksesshme, por edhe si një faktor të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për karrierën dhe avancimin profesional.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	8	4	5	4.88	.354
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	8	4	5	4.75	.463
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	8	3	5	4.50	.756
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	8	5	5	5.00	.000
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	8	4	5	4.75	.463
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	8	4	5	4.88	.354
Metodat e të mësuarit dhe të mësimeve kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	8	5	5	5.00	.000
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	8	4	5	4.63	.518
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	8	4	5	4.75	.463
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	8	5	5	5.00	.000
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	8	5	5	5.00	.000
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	8	5	5	5.00	.000
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	8	5	5	5.00	.000
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	8	5	5	5.00	.000
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	8	4	5	4.75	.463
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	8	4	5	4.88	.354
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	8	3	5	4.75	.707
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	8	4	5	4.88	.354

Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	8	4	5	4.88	.354
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	8	5	5	5.00	.000
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	8	4	5	4.88	.354
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	8	4	5	4.88	.354
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	8	4	5	4.75	.463
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	8	4	5	4.88	.354
Valid N (listwise)	8				

a. Programi i studimit: MSc në "Menaxhim në Inxhinieri"

1.1.4. MSc në “Business Analytics & Artificial Intelligence”

Studentët e programit **MSc në Business Analytics & Artificial Intelligence** shprehin vlerësime përgjithësisht pozitive për programin, megjithëse rezultatet paraqesin më shumë luhatje krahasuar me disa nga programet e tjera të analizuara. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, vlerësimet më të larta lidhen me përbalueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.40$) dhe balancën ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike ($M = 4.20$). Organizimi i programit ($M = 4.10$) dhe zhvillimi i aftësive analitike ($M = 4.00$) vlerësohen pozitivisht, ndërsa relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 3.90$) dhe përmbushja e objektivave akademike e profesionale ($M = 3.90$) marrin vlerësime disi më të moderuara. Këto rezultate sugjerojnë se studentët e vlerësojnë programin si të dobishëm dhe aktual, por njëkohësisht shprehin pritshmëri për forcimin e mëtejshëm të lidhjes ndërmjet përmbajtjes akademike dhe zhvillimit profesional.

Mësimdhënia dhe stafi akademik vlerësohen pozitivisht nga studentët, me treguesin më të lartë që lidhet me drejtësinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit ($M = 4.20$). Përgatitja profesionale e pedagogëve ($M = 4.10$), nxitja e mendimit kritik ($M = 4.00$) dhe mbështetja ndaj studentëve ($M = 3.90$) tregojnë një perceptim të favorshëm për cilësinë e procesit mësimor. Rezultatet sugjerojnë se studentët vlerësojnë pozitivisht jo vetëm kompetencën profesionale të pedagogëve, por edhe kontributin e tyre në krijimin e një mjedisi të favorshëm për të nxënë.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, vlerësimet janë më të rezervuara. Auditorët, laboratorët, pajisjet teknologjike dhe burimet akademike vlerësohen me mesatare prej 3.90, ndërsa mundësitë për mobilitet ndërkombëtar marrin një vlerësim prej 3.80. Treguesit me vlerësime më të ulëta lidhen me shërbimet administrative ($M = 3.60$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 3.40$). Kjo lë të kuptohet se studentët do të mirëprisnin më shumë mundësi për përfshirje në aktivitete praktike dhe një mbështetje institucionale më të dukshme në disa aspekte të përvojës së tyre universitare.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë pozitivisht kontributin e programit në zhvillimin e aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.00$), përgatitjen për fillimin e karrierës profesionale ($M = 4.00$) dhe rolin e praktikave profesionale në lidhjen e teorisë me praktikën ($M = 4.00$). Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 3.90$) dhe përfitimi i njohurive të nevojshme për tregun e punës ($M = 3.90$)

vlerësohen gjithashtu pozitivisht, megjithëse me një nivel disi më të moderuar. Në tërësi, studentët e konsiderojnë programin një përvojë të vlefshme studimi, e cila ka kontribuar në zhvillimin e kompetencave të tyre akademike dhe profesionale.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	10	1	5	4.10	1.370
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	10	1	5	3.90	1.370
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	10	1	5	4.20	1.317
Ngarkesa mësimore ka qenë e përbalueshme gjatë gjithë programit	10	2	5	4.40	1.075
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	10	1	5	4.00	1.414
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	10	1	5	4.00	1.414
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	10	1	5	4.00	1.414
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	10	1	5	4.00	1.414
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	10	1	5	3.90	1.449
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	10	1	5	4.10	1.370
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	10	1	5	3.90	1.370
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	10	1	5	4.20	1.317
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	10	1	5	4.00	1.491
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	10	1	5	3.90	1.524
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	10	1	5	3.90	1.524
Biblioteka dhe burimet e saj	10	1	5	3.90	1.524

akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme					
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	10	1	5	3.60	1.897
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	10	1	5	3.40	1.578
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	10	1	5	3.80	1.619
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	10	1	5	3.90	1.524
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	10	1	5	3.90	1.524
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	10	1	5	4.00	1.333
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	10	1	5	4.00	1.414
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	10	1	5	4.00	1.491
Valid N (listwise)	10				

a. Programi i studimit (plotëso): = MSc në "Business Analytics & Artificial Intelligence"

1.2. DEPARTAMENTI I SHKENCAVE ADMINISTRATIVE

1.2.1. BA në Administrim Biznesi me profile: “Menaxhim”, “Marketing”, “Sipërmarrje dhe Inovacion”

Studentët e programit **BA në Administrim Biznesi** shprehin një nivel shumë të lartë kënaqësie ndaj përmbajtjes dhe organizimit të programit të studimit. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, pothuajse të gjithë treguesit marrin vlerësime shumë të larta, duke reflektuar një perceptim pozitiv për strukturën akademike dhe orientimin e programit. Studentët vlerësojnë veçanërisht përballueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.82$) dhe rolin e programit në zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur ($M = 4.82$). Po ashtu, relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur, balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës dhe zhvillimi i aftësive për hulumtim e raportim marrin vlerësime të njëjta dhe shumë pozitive ($M = 4.76$). Treguesi me vlerësimin relativisht më të ulët në këtë kategori lidhet me nxitjen e pjesëmarrjes aktive të studentëve gjatë procesit mësimor ($M = 4.35$), megjithëse edhe ky rezultat mbetet qartësisht pozitiv.

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një tjetër aspekt të vlerësuar lart nga studentët. Përgatitja profesionale e pedagogëve ($M = 4.76$), nxitja e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive ($M = 4.76$), si dhe gatishmëria për të mbështetur studentët ($M = 4.71$) dëshmojnë një perceptim shumë të favorshëm për cilësinë e procesit mësimor. Edhe drejtësia dhe transparenca e vlerësimit ($M = 4.59$) marrin vlerësime të larta, duke treguar se studentët e konsiderojnë procesin akademik të drejtë dhe të besueshëm.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, rezultatet janë po ashtu shumë pozitive. Biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.76$), auditorët dhe laboratorët ($M = 4.71$), pajisjet teknologjike ($M = 4.71$) dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.71$) vlerësohen në nivele të larta. Shërbimet administrative ($M = 4.59$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.59$) marrin vlerësime disi më të ulëta brenda këtij grupi, por mbeten gjithsesi në një nivel shumë të kënaqshëm. Në tërësi, studentët shprehen se universiteti u ka ofruar një mjedis mbështetës për zhvillimin e studimeve të tyre.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, rezultatet tregojnë se programi perceptohet si një faktor i rëndësishëm në formimin e kompetencave profesionale dhe personale të

studentëve. Ndikimi pozitiv i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.76$), përgatitja për karrierën pas diplomimit ($M = 4.76$), roli i praktikave profesionale në lidhjen e teorisë me praktikën ($M = 4.76$) dhe zhvillimi i etikës profesionale ($M = 4.76$) janë ndër treguesit më të vlerësuar. Studentët raportojnë gjithashtu se kanë fituar njohuri dhe aftësi të vlefshme për tregun e punës ($M = 4.71$) dhe se programi ka kontribuar në zhvillimin e aftësive të tyre për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.65$). Në përgjithësi, rezultatet dëshmojnë një perceptim shumë pozitiv për ndikimin e programit në përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	17	3	5	4.76	.562
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	17	3	5	4.76	.562
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	17	3	5	4.76	.562
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	17	3	5	4.82	.529
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	17	3	5	4.71	.588
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	17	3	5	4.82	.529
Metodat e të mësuarit dhe të mësimeve kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	17	3	5	4.35	.606
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	17	3	5	4.76	.562
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	17	3	5	4.59	.618
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	17	3	5	4.76	.562
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	17	3	5	4.71	.588
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	17	3	5	4.59	.712
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	17	3	5	4.76	.562
Auditorët dhe laboratorët kanë	17	3	5	4.71	.588

qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit					
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	17	3	5	4.71	.588
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	17	3	5	4.76	.562
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	17	3	5	4.59	.618
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	17	3	5	4.59	.618
Studentët e programit **MSc në Inteligjencë Artificiale** shprehin vlerësime përgjithësisht pozitive për programin, ndërsa rezultatet tregojnë perceptime të ndryshme për dimensione të caktuara të përvojës së tyre akademike. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, studentët vlerësojnë më së shumti zhvillimin e aftësive profesionale për hulumtim dhe raportim ($M = 4.17$), përballueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.08$) dhe metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive ($M = 4.08$). Organizimi i programit ($M = 4.00$) dhe zhvillimi i aftësive analitike ($M = 4.00$) perceptohen gjithashtu pozitivisht. Ndërkohë, relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 3.83$), promovimi i punës në grup dhe mendimit të pavarur ($M = 3.83$) si dhe përmbushja e objektivave akademike e profesionale ($M = 3.75$) marrin vlerësime më të moderuara, duke sugjeruar se *studentët do të vlerësonin një lidhje edhe më të fortë ndërmjet përmbajtjes së programit dhe pritshmërive të tyre profesionale.*

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një nga aspektet më të vlerësuara të programit. Kompetenca e pedagogëve në zhvillimin e lëndëve ($M = 4.33$) dhe gatishmëria e tyre për të mbështetur studentët ($M = 4.25$) marrin vlerësime të larta. Studentët vlerësojnë pozitivisht edhe drejtësinë e procesit të vlerësimit ($M = 4.08$) dhe nxitjen e mendimit kritik e diskutimeve konstruktive ($M = 4.08$). Në tërësi, rezultatet tregojnë se stafi akademik perceptohet si një element i rëndësishëm në cilësinë e përvojës së studimit.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, rezultatet paraqesin një panoramë më të larmishme. Biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.17$) si dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.00$) vlerësohen pozitivisht nga studentët. Auditorët dhe laboratorët ($M = 3.92$) dhe pajisjet teknologjike ($M = 3.83$) marrin vlerësime të kënaqshme, ndërsa shërbimet administrative ($M = 3.58$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 3.25$) rezultojnë treguesit me vlerësimet më të ulëta të këtij dimension. Këto rezultate sugjerojnë se *studentët do të mirëprisnin më shumë mbështetje në aspektin e praktikave profesionale dhe të shërbimeve që lidhen drejtpërdrejt me jetën universitare.*

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë se programi ka kontribuar në zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të tyre. Përgatitja për fillimin e karrierës

profesionale ($M = 4.08$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.00$) marrin vlerësime pozitive. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 3.92$) dhe përfitimi i njohurive të nevojshme për tregun e punës ($M = 3.83$) vlerësohen gjithashtu në mënyrë të favorshme. Praktikant profesional dhe roli i tyre në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune ($M = 3.33$) paraqiten si treguesi më i moderuar i këtij dimension, duke lënë të kuptohet se *studentët do të vlerësonin më shumë mundësi për përfshirje praktike dhe kontakte me mjediset profesionale të fushës*. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se programi perceptohet si një mundësi e rëndësishme për zhvillimin e kompetencave në fushat e inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike dhe shkencës së të dhënave.

Descriptive Statistics ^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	12	3	5	4.00	1.044
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	12	1	5	3.83	1.403
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	12	1	5	3.75	1.422
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	12	2	5	4.08	1.165
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	12	2	5	4.00	1.128
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	12	1	5	3.83	1.403
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxjerrje pjesëmarrjen aktive të studentëve	12	1	5	4.08	1.240
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	12	1	5	4.17	1.267
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	12	1	5	3.75	1.357
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	12	2	5	4.33	1.073
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	12	2	5	4.25	1.055
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	12	3	5	4.08	.996
Pedagogët kanë nxjerrje zhvillimin e mendimit kritik dhe	12	2	5	4.08	.996

diskutimeve konstruktive					
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	12	1	5	3.92	1.379
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	12	1	5	3.83	1.403
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	12	1	5	4.17	1.267
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	12	1	5	3.58	1.730
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	12	1	5	3.25	1.815
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	12	1	5	4.00	1.414
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	12	1	5	3.92	1.311
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	12	1	5	3.83	1.337
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	12	1	5	4.08	1.443
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	12	1	5	4.00	1.348
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	12	1	5	3.33	1.670
Valid N (listwise)	12				

a. Programi i studimit: MSc në " Inteligjencë Artificiale" me profile "Cyber Security" dhe "Data Science"

2.1.6. Program Profesional në “Dizajn dhe Zhvillim Software”

Studentët e **Programit Profesional në Dizajn dhe Zhvillim Software** shprehin vlerësime pozitive për programin dhe për përvojën e tyre të studimit. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, studentët vlerësojnë më së shumti zhvillimin e aftësive profesionale për hulumtim dhe raportim ($M = 4.12$), relevancën e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.08$), si dhe promovimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur ($M = 4.08$). Ngarkesa mësimore ($M = 4.08$) dhe balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës ($M = 4.00$) perceptohen gjithashtu pozitivisht. Treguesi me vlerësimin më të ulët në këtë kategori lidhet me metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve ($M = 3.60$), duke sugjeruar se *studentët do të mirëprisnin më shumë aktivitete interaktive dhe forma të të nxënies të orientuara drejt angazhimit praktik*.

Mësimdhënia dhe stafi akademik vlerësohen në mënyrë të favorshme nga studentët. Mbështetja e ofruar nga pedagogët për adresimin e nevojave dhe shqetësimeve të studentëve ($M = 4.04$), drejtësia e procesit të vlerësimit ($M = 4.04$) dhe nxitja e mendimit kritik ($M = 4.04$) përfaqësojnë treguesit më të vlerësuar të këtij dimension. Kompetenca profesionale e pedagogëve ($M = 3.92$) perceptohet gjithashtu pozitivisht. Në tërësi, rezultatet tregojnë se studentët kanë krijuar një perceptim të mirë për cilësinë e procesit mësimor dhe për angazhimin e stafit akademik.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët shprehen të kënaqur me pajisjet teknologjike të përdorura në procesin mësimor ($M = 4.12$), bibliotekën dhe burimet akademike ($M = 4.08$) si dhe shërbimet administrative ($M = 4.08$). Auditorët dhe laboratorët ($M = 3.96$), mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 3.96$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 3.92$) marrin vlerësime pozitive, por më të moderuara. Kjo sugjeron se *studentët do të vlerësonin zgjerimin e mëtejshëm të mundësive për praktika profesionale dhe përvoja ndërkombëtare që lidhen me profilin e programit*.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë se programi ka kontribuar në zhvillimin e kompetencave të tyre profesionale. Ndikimi pozitiv në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.12$) përbën treguesin më të vlerësuar të këtij dimension. Studentët shprehen gjithashtu se kanë fituar njohuri të dobishme për tregun e punës ($M = 4.00$) dhe ndihen të përgatitur për të filluar karrierën profesionale pas diplomimit ($M = 4.00$). Praktikrat profesionale

($M = 3.92$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 3.96$) perceptohen pozitivisht, duke treguar se programi ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale në fushën e zhvillimit software.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	25	1	5	3.96	1.241
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	25	1	5	4.08	1.038
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	25	1	5	4.00	1.155
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	25	2	5	4.08	.954
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	25	1	5	3.96	.978
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	25	1	5	4.08	1.115
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	25	1	5	3.60	1.190
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	25	1	5	4.12	1.092
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	25	2	5	3.92	1.077
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	25	1	5	3.92	1.038
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	25	1	5	4.04	1.020
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	25	1	5	4.04	1.020
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	25	1	5	4.04	1.020
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	25	1	5	3.96	1.098
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	25	1	5	4.12	1.054
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të	25	2	5	4.08	.862

aksesueshme dhe të dobishme					
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	25	1	5	4.08	.997
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	25	1	5	3.92	1.038
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	25	1	5	3.96	1.172
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	25	1	5	4.12	1.013
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	25	1	5	4.00	1.258
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	25	1	5	4.00	1.041
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	25	1	5	3.96	1.060
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	25	1	5	3.92	1.038
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	25	1	5	4.00	1.000
Valid N (listwise)	25				

a. Programi i studimit: Program Profesional në “Dizajn dhe Zhvillim Software”

2.2. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE ELEKTRONIKE

2.2.1. BA në Inxhinieri Elektrike me profile: “Sistemet e fuqisë”, “Elektronikë”, “Komunikime dixhitale”

Studentët e programit **BA në Inxhinieri Elektrike** shprehin vlerësime shumë pozitive për përvojën e tyre të studimit dhe për cilësinë e programit në tërësi. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, organizimi i programit ($M = 4.64$) dhe relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.64$) rezultojnë ndër aspektet më të vlerësuara. Studentët vlerësojnë gjithashtu ngarkesën mësimore si të përballueshme ($M = 4.59$), zhvillimin e aftësive për punë në grup dhe mendim të pavarur ($M = 4.55$), si dhe kontributin e programit në zhvillimin e aftësive profesionale për hulumtim dhe raportim ($M = 4.55$). Edhe pse balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës ($M = 4.36$) dhe pjesëmarrja aktive në procesin mësimor ($M = 4.18$) marrin vlerësime disi më të ulëta se treguesit e tjerë, ato mbeten qartësisht pozitive.

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një nga pikat më të forta të programit. Kompetenca e pedagogëve ($M = 4.55$), angazhimi i tyre në mbështetje të studentëve ($M = 4.55$), drejtësia e procesit të vlerësimit ($M = 4.55$) dhe nxitja e mendimit kritik ($M = 4.55$) marrin vlerësime pothuajse identike dhe shumë të larta. Këto rezultate tregojnë një nivel të konsiderueshëm besimi të studentëve ndaj stafit akademik dhe cilësisë së procesit të mësimdhënies.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët japin vlerësime të favorshme për të gjithë treguesit kryesorë. Shërbimet administrative ($M = 4.59$) dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.59$) janë ndër elementet më të vlerësuara të këtij dimension. Po ashtu, pajisjet teknologjike ($M = 4.45$), biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.45$) si dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.45$) perceptohen pozitivisht nga studentët. Auditorët dhe laboratorët ($M = 4.36$) marrin një vlerësim pak më të moderuar, por gjithsesi tregojnë kënaqësi të lartë me kushtet e ofruara për procesin mësimor.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët raportojnë rezultate veçanërisht pozitive. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.68$) përbën treguesin më të lartë të kësaj kategorie, duke reflektuar bindjen e studentëve se studimet kanë kontribuar realisht në formimin e tyre. Po ashtu, praktikat profesionale dhe roli i tyre në

zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune ($M = 4.64$) vlerësohen shumë pozitivisht. Përfitimi i njohurive dhe aftësive për tregun e punës ($M = 4.50$), përgatitja për karrierën profesionale ($M = 4.50$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim e menaxhim ($M = 4.50$) konfirmojnë perceptimin se programi u ka ofruar studentëve një bazë të fortë për integrimin e tyre në fushën profesionale të inxhinierisë elektrike.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	22	3	5	4.64	.727
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	22	3	5	4.64	.727
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	22	1	5	4.36	1.217
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	22	3	5	4.59	.734
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	22	1	5	4.50	1.012
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	22	1	5	4.55	1.011
Metodat e të mësuarit dhe të mësimdhënies kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	22	1	5	4.18	1.097
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	22	1	5	4.55	1.011
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	22	1	5	4.45	1.143
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	22	1	5	4.55	.963
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	22	1	5	4.55	1.011
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	22	1	5	4.55	.963
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	22	1	5	4.55	.963
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimin	22	2	5	4.36	1.136

Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	22	1	5	4.45	1.057
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	22	1	5	4.45	1.143
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	22	2	5	4.59	.854
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	22	1	5	4.45	1.057
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	22	3	5	4.59	.796
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	22	3	5	4.68	.646
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	22	1	5	4.50	1.102
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	22	1	5	4.50	1.102
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	22	1	5	4.50	1.102
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	22	2	5	4.64	.790
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	22	1	5	4.55	1.057
Programi i studimit:	22	9	9	9.00	.000
Valid N (listwise)	22				

a. Programi i studimit: BA në Inxhinieri Elektrike me profile: "Sistemet e fuqisë", "Elektronikë", "Komunikime dixhitale"

2.2.2. MSc në Inxhinieri Elektrike me dy profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrië”

Studentët e programit **MSc në Inxhinieri Elektrike** shprehin vlerësime shumë pozitive për programin dhe për cilësinë e përvojës së tyre akademike. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, studentët vlerësojnë veçanërisht metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive ($M = 4.71$), ndërsa organizimi i programit ($M = 4.64$), balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës ($M = 4.64$), përballueshmëria e ngarkesës mësimore ($M = 4.64$) dhe zhvillimi i aftësive analitike ($M = 4.64$) marrin gjithashtu vlerësime shumë të larta. Relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.50$) mbetet në nivele të larta vlerësimi, duke treguar se studentët e konsiderojnë programin të lidhur ngushtë me nevojat e fushës profesionale.

Mësimdhënia dhe stafi akademik paraqiten si një tjetër element i fortë i programit. Kompetenca e pedagogëve ($M = 4.64$), angazhimi i tyre në mbështetje të studentëve ($M = 4.64$) dhe nxitja e mendimit kritik e diskutimeve konstruktive ($M = 4.64$) vlerësohen në mënyrë shumë pozitive. Edhe procesi i vlerësimit të studentëve ($M = 4.57$) perceptohet si i drejtë dhe transparent. Në tërësi, rezultatet sugjerojnë një marrëdhënie të konsoliduar ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, si dhe një klimë të favorshme për zhvillimin e procesit mësimor.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët raportojnë nivele të larta kënaqësie. Shërbimet administrative ($M = 4.71$) përbëjnë treguesin më të vlerësuar të këtij dimensionit, ndërsa pajisjet teknologjike ($M = 4.64$), kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.64$) dhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.57$) marrin gjithashtu vlerësime shumë pozitive. Auditorët dhe laboratorët ($M = 4.50$) si dhe biblioteka me burimet e saj akademike ($M = 4.57$) vlerësohen në mënyrë të favorshme, duke reflektuar një perceptim pozitiv për mbështetjen që universiteti ofron gjatë studimeve.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë se programi ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin e tyre. Përfitimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për tregun e punës ($M = 4.64$) dhe kontributi i praktikave profesionale në zbatimin e njohurive teorike ($M = 4.64$) janë ndër treguesit më të vlerësuar. Ndikimi pozitiv i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.57$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.57$) konfirmojnë këtë perceptim. Edhe pse përgatitja për fillimin e karrierës

profesionale pas diplomimit ($M = 4.43$) paraqet vlerësimin më të moderuar të kësaj kategorie, ajo mbetet në një nivel qartësisht pozitiv. Në tërësi, rezultatet tregojnë se studentët e konsiderojnë programin një përvojë akademike me vlerë, e cila kontribuon në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe teknike të nevojshme për fushën e energjetikës dhe automatizimit industrial.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	14	3	5	4.64	.633
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	14	3	5	4.50	.760
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	14	3	5	4.64	.633
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	14	3	5	4.64	.745
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	14	3	5	4.64	.745
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	14	3	5	4.64	.745
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	14	3	5	4.71	.611
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	14	3	5	4.64	.745
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	14	3	5	4.64	.745
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	14	3	5	4.64	.745
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	14	3	5	4.64	.745
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	14	2	5	4.57	.938
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	14	3	5	4.64	.745
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	14	2	5	4.50	.941
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	14	3	5	4.64	.745
Biblioteka dhe burimet e saj	14	2	5	4.57	.938

akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme					
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	14	3	5	4.71	.611
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	14	3	5	4.64	.745
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	14	2	5	4.57	.938
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	14	2	5	4.57	.938
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	14	3	5	4.64	.745
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	14	2	5	4.43	.938
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	14	2	5	4.57	.938
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	14	3	5	4.64	.745
Valid N (listwise)	14				

a. Programi i studimit: MSc në Inxhinieri Elektrike me dy profile: "Energjetikë", "Automatizim Industrie"

III. FAKULTETI I INXHINIERISË DHE ARKITEKTURËS

3.1. DEPARTAMENTI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

3.1.1. BA në “Inxhinieri Ndërtimi”

Studentët e programit **BA në Inxhinieri Ndërtimi** paraqesin një vlerësim pozitiv për programin e studimit dhe për përvojën e tyre universitare në tërësi. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, vlerësimet më të larta lidhen me përballueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.45$), zhvillimin e aftësive profesionale për hulumtim dhe raportim ($M = 4.45$), si dhe relevancën e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.43$). Studentët vlerësojnë gjithashtu kontributin e lëndëve në zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve ($M = 4.43$) dhe organizimin e përgjithshëm të programit ($M = 4.33$). Ndërkohë, metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve ($M = 3.76$) rezultojnë treguesi me vlerësimin më të moderuar të kësaj kategorie, duke sugjeruar se *studentët do të mirëprisnin më shumë aktivitete praktike, diskutime dhe forma interaktive të të nxënit gjatë procesit mësimor*.

Mësimdhënia dhe stafi akademik perceptohen pozitivisht nga studentët. Kompetenca e pedagogëve ($M = 4.38$) dhe aftësia e tyre për të nxitur mendimin kritik dhe diskutimet konstruktive ($M = 4.38$) përbëjnë aspektet më të vlerësuara të këtij dimension. Angazhimi i pedagogëve për të mbështetur studentët ($M = 4.31$) vlerësohet gjithashtu në mënyrë të favorshme. Procesi i vlerësimit të studentëve ($M = 4.14$) paraqitet me një vlerësim disi më të moderuar, por mbetet qartësisht pozitiv. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se studentët kanë krijuar një perceptim të mirë për cilësinë e mësimdhënies dhe marrëdhënien me stafin akademik.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët shprehen të kënaqur me shumicën e treguesve të vlerësuar. Mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.38$), biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.36$), shërbimet administrative ($M = 4.33$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.33$) marrin vlerësime pozitive. Pajisjet teknologjike ($M = 4.31$) dhe auditorët e laboratorët ($M = 4.26$) vlerësohen gjithashtu mirë nga studentët. Këto rezultate sugjerojnë se universiteti perceptohet si një mjedis mbështetës për zhvillimin e procesit mësimor dhe profesional.

*Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët vlerësojnë se programi ka pasur një ndikim të dukshëm në formimin e tyre. Ndikimi pozitiv i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.50$) përbën treguesin më të vlerësuar të kësaj kategorie. Po ashtu, zhvillimi i etikës dhe disiplinës profesionale ($M = 4.40$), përgatitja për fillimin e karrierës pas diplomimit ($M = 4.36$) dhe përfitimi i njohurive të nevojshme për tregun e punës ($M = 4.31$) marrin vlerësime të larta. Praktikat profesionale dhe roli i tyre në zbatimin e njohurive teorike në situata reale pune ($M = 4.24$) vlerësohen pozitivisht, ndërsa rezultatet sugjerojnë se *forcimi i mëtejshëm i komponentit praktik do të ishte një zhvillim i mirëpritur nga një pjesë e studentëve*. Në tërësi, studentët e konsiderojnë programin një bazë të mirë për zhvillimin e kompetencave profesionale në fushën e inxhinierisë së ndërtimit.*

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	42	3	5	4.33	.874
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	42	2	5	4.43	.859
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	42	3	5	4.31	.869
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	42	2	5	4.45	.889
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	42	3	5	4.43	.770
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	42	2	5	4.33	.928
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	42	2	5	3.76	1.100
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	42	3	5	4.45	.803
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	42	2	5	4.33	.954
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	42	1	5	4.38	.987
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	42	1	5	4.31	1.000
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	42	1	5	4.14	1.160

Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	42	1	5	4.38	.987
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimi	42	1	5	4.26	1.014
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	42	1	5	4.31	1.024
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	42	1	5	4.36	.983
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	42	2	5	4.33	.979
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	42	2	5	4.33	.954
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	42	1	5	4.38	1.103
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	42	3	5	4.50	.773
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	42	1	5	4.31	1.024
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	42	2	5	4.36	.879
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	42	2	5	4.31	.950
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	42	2	5	4.24	1.055
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	42	2	5	4.40	.857
Programi i studimit:	42	5	5	5.00	.000
Valid N (listwise)	42				

a. Programi i studimit: BA në "Inxhinieri Ndërtimi"

3.1.2. *MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile: “Inxhinieri Strukturash”, “Inxhinieri Infrastrukturë Transporti”*

Studentët e programit **MSc në Inxhinieri Ndërtimi** paraqesin vlerësime të larta për pothuajse të gjitha aspektet e programit, duke reflektuar një perceptim pozitiv për cilësinë e studimeve dhe përvojën e tyre akademike. *Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit*, organizimi i qartë i programit ($M = 4.41$), promovimi i aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur ($M = 4.41$), relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.39$) dhe përballueshmëria e ngarkesës mësimore ($M = 4.36$) rezultojnë ndër treguesit më të vlerësuar. Studentët vlerësojnë pozitivisht edhe zhvillimin e aftësive analitike ($M = 4.34$) dhe metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive ($M = 4.32$). Treguesi me vlerësimin më të moderuar në këtë kategori lidhet me zhvillimin e aftësive profesionale për hulumtim dhe raportim ($M = 4.16$), megjithëse edhe ky rezultat mbetet në një nivel të lartë vlerësimi.

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një nga elementet më të vlerësuara të programit. Kompetenca e pedagogëve ($M = 4.52$) dhe drejtësia e procesit të vlerësimit ($M = 4.52$) ndajnë vlerësimin më të lartë në këtë dimension. Po ashtu, studentët vlerësojnë angazhimin e pedagogëve për të mbështetur studentët ($M = 4.46$) dhe nxitjen e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive ($M = 4.41$). Këto rezultate tregojnë një nivel të lartë besimi te stafi akademik dhe te cilësia e procesit mësimor.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët shprehin vlerësime të favorshme për kushtet dhe shërbimet e ofruara nga universiteti. Pajisjet teknologjike ($M = 4.43$) dhe auditorët e laboratorët ($M = 4.39$) perceptohen pozitivisht, ndërsa biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.34$), shërbimet administrative ($M = 4.34$) dhe kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.34$) marrin gjithashtu vlerësime të mira. Mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.38$) vlerësohen pozitivisht, duke treguar se studentët e konsiderojnë universitetin si një mjedis mbështetës për zhvillimin akademik dhe profesional.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, rezultatet tregojnë se studentët e shohin programin si një faktor të rëndësishëm në formimin e tyre profesional. Përgatitja për fillimin e karrierës pas diplomimit ($M = 4.41$) përbën treguesin më të vlerësuar të kësaj kategorie. Studentët raportojnë gjithashtu se kanë fituar njohuri dhe aftësi të nevojshme për tregun e punës

($M = 4.37$), se praktikat profesionale kanë ndihmuar në lidhjen e teorisë me praktikën ($M = 4.37$) dhe se programi ka kontribuar në zhvillimin e aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.38$). Ndikimi pozitiv i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.34$) plotëson këtë panoramë, duke treguar se studentët e konsiderojnë programin një përvojë të vlefshme që i ka përgatitur për sfidat profesionale në fushën e inxhinierisë së ndërtimit.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	56	3	5	4.41	.781
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	56	2	5	4.39	.867
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	56	1	5	4.30	1.060
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	56	2	5	4.36	.862
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	56	2	5	4.34	.940
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	56	2	5	4.41	.890
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	56	2	5	4.32	.917
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	56	1	5	4.16	1.058
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	56	2	5	4.32	.834
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	56	2	5	4.52	.786
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	56	2	5	4.46	.830
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	56	1	5	4.52	.853
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	56	1	5	4.41	.987
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	56	1	5	4.39	.966
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar	56	1	5	4.43	.850

nevojat e programit					
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	56	1	5	4.34	.880
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	56	2	5	4.34	.880
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	56	2	5	4.34	.920
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	56	3	5	4.38	.822
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	56	1	5	4.34	.959
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	56	1	5	4.37	1.019
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	56	1	5	4.41	.910
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	56	1	5	4.38	1.001
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	56	1	5	4.37	1.037
Valid N (listwise)	56				

a. Programi i studimit: MSc në Inxhinieri Ndërtimi me profile: "Inxhinieri Strukturash", "Inxhinieri Infrastrukturë Transporti"

3.2. DEPARTAMENTI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS

3.2.1. Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë

Studentët e **Programit të Integruar të Nivelit të Dytë në Arkitekturë** shprehin vlerësime pozitive për programin dhe për përvojën e tyre gjatë studimeve. Në dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit, aspekti më i vlerësuar lidhet me relevancën e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.53$), çka tregon se studentët e perceptojnë programin si të lidhur ngushtë me kërkesat dhe specifikat e profesionit të arkitektit. Organizimi i programit ($M = 4.47$), përmbushja e objektivave akademike dhe profesionale ($M = 4.47$) si dhe zhvillimi i aftësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve ($M = 4.42$) marrin gjithashtu vlerësime të larta. Ndërkohë, metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve ($M = 4.00$) dhe përballueshmëria e ngarkesës mësimore ($M = 4.16$) paraqiten me vlerësime disi më të moderuara, duke sugjeruar se *studentët do të vlerësonin më shumë mundësi për angazhim aktiv dhe organizim fleksibël të ngarkesës së studimeve.*

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një nga elementet më të vlerësuara të programit. Angazhimi i pedagogëve për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre ($M = 4.58$) rezulton treguesi më i lartë i kësaj kategorie. Studentët vlerësojnë gjithashtu drejtësinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit ($M = 4.37$), nxitjen e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive ($M = 4.37$) si dhe kompetencën profesionale të pedagogëve ($M = 4.26$). Në tërësi, rezultatet tregojnë se marrëdhënia ndërmjet studentëve dhe stafit akademik perceptohet si mbështetëse dhe pozitive.

Në aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale, studentët japin vlerësime të mira për shumicën e treguesve të analizuar. Mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 4.37$), auditorët dhe laboratorët ($M = 4.32$) si dhe pajisjet teknologjike ($M = 4.32$) perceptohen pozitivisht. Biblioteka dhe burimet akademike ($M = 4.21$) dhe shërbimet administrative ($M = 4.21$) marrin gjithashtu vlerësime të favorshme. Kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 4.26$) vlerësohen pozitivisht, duke treguar se studentët e konsiderojnë të rëndësishëm lidhjen e studimeve me përvojën praktike profesionale.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët raportojnë se programi ka

ndikuar pozitivisht në formimin e tyre. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 4.37$), përfitimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për tregun e punës ($M = 4.37$) si dhe kontributi i praktikave profesionale në zbatimin e njohurive teorike në situata reale ($M = 4.37$) janë ndër aspektet më të vlerësuara të këtij dimensionit. Përgatitja për fillimin e karrierës profesionale ($M = 4.26$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 4.26$) marrin gjithashtu vlerësime pozitive. Në tërësi, rezultatet sugjerojnë se studentët e shohin programin si një përvojë të vlefshme akademike dhe profesionale, e cila ka kontribuar në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për ushtrimin e profesionit të arkitektit.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	19	2	5	4.47	.964
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	19	3	5	4.53	.772
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	19	2	5	4.37	.895
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	19	2	5	4.16	1.167
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	19	3	5	4.42	.769
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	19	2	5	4.26	.933
Metodat e të mësuarit dhe të mësimeve kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	19	3	5	4.00	.816
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	19	1	5	4.37	1.065
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	19	2	5	4.47	.905
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	19	2	5	4.26	.933
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	19	2	5	4.58	.902
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	19	2	5	4.37	.895
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	19	3	5	4.37	.831
Auditorët dhe laboratorët kanë	19	2	5	4.32	.885

qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit					
Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	19	3	5	4.32	.820
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	19	2	5	4.21	.976
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	19	2	5	4.21	1.084
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	19	2	5	4.26	.933
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	19	3	5	4.37	.831
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	19	2	5	4.37	.955
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	19	3	5	4.37	.831
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	19	3	5	4.26	.872
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	19	2	5	4.26	.991
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	19	2	5	4.37	.955
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	19	3	5	4.32	.885
Programi i studimit:	19	10	10	10.00	.000
Valid N (listwise)	19				

a. Programi i studimit: Program i Integruar i Nivelit të Dytë në Arkitekturë

3.2.2. Program Profesional në “Grafik Dizajn”

Studentët e **Programit Profesional në Grafik Dizajn** shprehin vlerësime pozitive për programin, ndërsa rezultatet tregojnë disa dallime ndërmjet aspekteve të ndryshme të përvojës së studimit. Në *dimensionin e përmbajtjes dhe organizimit të programit*, studentët vlerësojnë më së shumti përballueshmërinë e ngarkesës mësimore ($M = 4.17$) dhe përmbushjen e objektivave akademike e profesionale ($M = 4.06$). Relevanca e përmbajtjes për profesionin e zgjedhur ($M = 4.00$) dhe kontributi i lëndëve në zhvillimin e aftësive analitike ($M = 4.00$) perceptohen gjithashtu pozitivisht. Nga ana tjetër, metodat e mësimdhënies që nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve ($M = 3.67$) paraqiten me vlerësimin më të moderuar në këtë kategori, duke sugjeruar se *studentët do të mirëprisnin më shumë aktivitete praktike, projekte krijuese dhe forma të të nxënies të bazuara në bashkëpunim*.

Mësimdhënia dhe stafi akademik përbëjnë një nga aspektet më të vlerësuara të programit. Angazhimi i pedagogëve për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre ($M = 4.33$) rezulton treguesi më i lartë i këtij dimension. Studentët vlerësojnë gjithashtu nxitjen e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive ($M = 4.28$), kompetencën profesionale të pedagogëve ($M = 4.17$) dhe drejtësinë e procesit të vlerësimit ($M = 4.11$). Këto rezultate tregojnë se studentët e perceptojnë stafin akademik si një mbështetje të rëndësishme në zhvillimin e tyre profesional dhe krijues.

Në *aspektin e infrastrukturës dhe mbështetjes institucionale*, vlerësimet janë përgjithësisht pozitive, megjithëse disa tregues paraqiten më të moderuar. Shërbimet administrative ($M = 4.11$) dhe biblioteka me burimet e saj akademike ($M = 3.94$) marrin vlerësimet më të larta në këtë kategori. Kushtet për zhvillimin e praktikave profesionale ($M = 3.89$), auditorët dhe laboratorët ($M = 3.78$) si dhe pajisjet teknologjike ($M = 3.78$) vlerësohen pozitivisht, por lënë hapësirë për përmirësim. Edhe mundësitë për mobilitet ndërkombëtar ($M = 3.83$) paraqiten me një vlerësim më të rezervuar. Kjo sugjeron se *studentët do të vlerësonin zgjerimin e mundësive praktike dhe të infrastrukturës që mbështet procesin krijues dhe profesional në fushën e dizajnit*.

Për sa i përket përvojës personale dhe zhvillimit profesional, studentët raportojnë se programi ka pasur një ndikim pozitiv në formimin e tyre. Përgatitja për fillimin e karrierës profesionale ($M = 4.11$) dhe zhvillimi i etikës dhe disiplinës profesionale ($M = 4.06$) janë ndër treguesit më të

vlerësuar të këtij dimension. Ndikimi i programit në zhvillimin personal dhe profesional ($M = 3.94$), fitimi i njohurive dhe aftësive për tregun e punës ($M = 3.94$) dhe zhvillimi i aftësive për planifikim dhe menaxhim ($M = 3.94$) marrin gjithashtu vlerësime pozitive. Praktikën profesionale dhe rolin e tyre në lidhjen e njohurive teorike me përvojën reale të punës ($M = 3.89$) vlerësohen në mënyrë të favorshme, ndërsa rezultatet tregojnë se studentët e konsiderojnë programin një bazë të mirë për zhvillimin e kompetencave profesionale në fushën e dizajnit grafik.

Descriptive Statistics^a					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	18	1	5	3.83	1.249
Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	18	1	5	4.00	1.237
Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	18	1	5	3.83	1.200
Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	18	2	5	4.17	1.043
Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	18	1	5	4.00	1.237
Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	18	1	5	3.89	1.323
Metodat e të mësuarit dhe të mësimit kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	18	1	5	3.67	1.237
Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	18	1	5	4.00	1.237
Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	18	1	5	4.06	1.162
Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	18	1	5	4.17	1.200
Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	18	1	5	4.33	1.138
Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	18	1	5	4.11	1.231
Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive	18	1	5	4.28	1.074
Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimit	18	1	5	3.78	1.309
Pajisjet teknologjike	18	1	5	3.78	1.309

(kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit					
Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	18	1	5	3.94	1.259
Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	18	2	5	4.11	.963
Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	18	1	5	3.89	1.278
Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	18	2	5	3.83	1.150
Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	18	1	5	3.94	1.259
Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	18	1	5	3.94	1.211
Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	18	1	5	4.11	1.183
Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	18	1	5	3.94	1.259
Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	18	1	5	3.89	1.183
Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	18	1	5	4.06	1.110
Valid N (listwise)	18				

a. Programi i studimit: Program Profesional në “Grafik Dizajn”

Aneks - FORMULAR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA STUDENTËT NË PRAG DIPLOMIMI

Ky pyetësor organizohet nga Universiteti Metropolitan Tirana me qëllim mbledhjen e opinioneve tuaja për programin e studimit që keni ndjekur. Ky vlerësim do të ndihmojë në matjen e cilësisë së përmbajtjes akademike, të mësimdhënies dhe të mbështetjes institucionale, si dhe në identifikimin e mundësive për zhvillim të mëtejshëm.

Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të përdoren për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit dhe për adresimin e nevojave të studentëve.

Ky pyetësor është përgatitur dhe administrohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Faleminderit për kontributin dhe përkushtimin tuaj!

Gjinia

- ☐ Femër
☐ Mashkull

Programi i studimit (plotëso): Bachelor në: Program profesional në: MSc në: MP në: Doktoratë në:	
Viti Akademik	

Ju lutemi të vlerësoni secilin prej pohimeve të mëposhtme duke përdorur shkallën nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht ‘Nuk pajtohem aspak’, ‘Nuk pajtohem’, ‘Jam neutral’, ‘Pajtohem’, ‘Pajtohem plotësisht’.

Nr.		Pohimi	Vlerësimi				
Përmbajtja dhe organizimi i programit							
1	Programi i studimit është organizuar në mënyrë të qartë dhe logjike	1	2	3	4	5	
2	Përmbajtja e programit është relevante për profesionin e zgjedhur	1	2	3	4	5	
3	Programi ofron një balancë të mirë ndërmjet lëndëve teorike dhe praktike	1	2	3	4	5	
4	Ngarkesa mësimore ka qenë e përballueshme gjatë gjithë programit	1	2	3	4	5	
5	Lëndët e programit nxisin zhvillimin e aftësive analitike dhe zgjidhjen e problemeve	1	2	3	4	5	
6	Programi promovon zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe mendimit të pavarur	1	2	3	4	5	
7	Metodat e të mësuarit dhe të mësimdhënies kanë nxitur pjesëmarrjen aktive të studentëve	1	2	3	4	5	
8	Programi zhvillon aftësitë profesionale për hulumtim dhe raportim	1	2	3	4	5	
9	Programi përmbush objektivat e tij akademike dhe profesionale	1	2	3	4	5	
Mësimdhënia dhe stafi akademik							

10	Pedagogët kanë qenë të përgatitur dhe kompetentë në dhënien e lëndëve	1	2	3	4	5
11	Pedagogët kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar studentët dhe për të adresuar shqetësimet e tyre	1	2	3	4	5
12	Vlerësimi i studentëve ka qenë i drejtë, transparent dhe i përshtatshëm për lëndën	1	2	3	4	5
13	Pedagogët kanë nxitur zhvillimin e mendimit kritik dhe diskutimeve konstruktive					
<i>Infrastruktura dhe mbështetja institucionale</i>						
14	Auditorët dhe laboratorët kanë qenë të përshtatshëm për zhvillimin e mësimin	1	2	3	4	5
15	Pajisjet teknologjike (kompjuterë, internet, laboratorë) kanë plotësuar nevojat e programit	1	2	3	4	5
16	Biblioteka dhe burimet e saj akademike kanë qenë të aksesueshme dhe të dobishme	1	2	3	4	5
17	Shërbimet administrative kanë qenë efektive dhe mbështetëse ndaj studentëve	1	2	3	4	5
18	Universiteti ka krijuar kushte për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve	1	2	3	4	5
19	Universiteti ka ofruar mundësi për mobilitet ndërkombëtar, përfshirë shkëmbime studentore apo projekte ndërkombëtare	1	2	3	4	5
<i>Përvoja personale dhe zhvillimi profesional</i>						
20	Programi i studimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin tim personal dhe profesional	1	2	3	4	5
21	Kam fituar njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të punës	1	2	3	4	5
22	Ndihem i/e përgatitur për të filluar një karrierë profesionale pas diplomimit	1	2	3	4	5
23	Programi ka zhvilluar aftësitë e mia për planifikim dhe menaxhim	1	2	3	4	5
24	Praktikat profesionale kanë ndihmuar në zbatimin e njohurive teorike në mjedise reale pune	1	2	3	4	5
25	Programi ka zhvilluar etikën dhe disiplinën time në marrëdhëniet profesionale	1	2	3	4	5

Shënime shtesë: *Ju lutemi, nëse keni diçka më shumë, ndani mendimin tuaj mbi mënyrën si mund të përmirësohet më tej programi i studimit që keni ndjekur:* _____